



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 14 maj 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fisnik Ismaili, Jasmina Zhivković dhe Imet Rrahmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

**Nait Hasani** propozoi që shqyrtimi i P/ligjit të bëhet nen për nen.

Gjatë shqyrtimit të P/ligjit komisioni ka hartuar këto propozim- ndryshime si vijon:

#### **Amandamenti 1**

**Neni 17, paragrafi 3**, pas fjalës “(5) ditësh”, shtohet fjala “pune”.

#### **Amendamenti 2**

**Neni 19, paragrafi 6**, pas fjalës “prej” fshihet fjala “prej”.

#### **Amendamenti 3**

**Neni 27, paragrafi 2**, pas fjalëve “Republikës së Kosovës.” fshihet teksti “ i cili buxhet nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm. Buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Këshillit”.

#### **Amendamenti 4**

**Neni 27, paragrafi 6**, pas fjalës “Këshillit”, shtohet fjala “caktohet” dhe fshihet teksti “është ekuivalent me pagën e kryetarit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme”.

#### **Amendamenti 5**

**Neni 31, paragrafi 2**, fshihet teksti në tërësi.

---

**Konstatim:** Komisioni shqyrtoi propozim - amendamentet e deputetit, Armend Zemaj për nenet 8 dhe nenin 9, të dt.26 prill 2018, dhe nuk i përkrahu.

### **3. Të ndryshme.**

Komisioni për këtë pikë të rendit të ditës ka diskutuar për propozimet për tekstin e draft-ligjit për RTK-në lidhur me parapagimin për RTK, shumën e parapagimit, këshillin konsultativ rreth funksionimit të tij, si organ i jashtëm i RTK-së apo si Këshill i brendshëm i emëruar nga bordi i RTK-së.

Konstatim: Komisioni ka vendosur që grupi punues, i përbërë nga anëtarët e komisionit, të takohet përsëri për harmonizimin e tekstit të draftit me propozimet e reja.

#### **E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----  
Nait Hasani